Taksa e Pulles
700

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISRIA E DREJTESISE Nr. 2577 Rep.
DHOMA E NOTERISE TIRANE Nr. 881 Kol./ 2

## KONTRATE SHITJE

## (KUOTASH)

**Transferimi i 33 % kuotave te kapitalit te Shoqërisë SEA Consulting SHPK**

*Ne Tirane, sot date 05.10.**2018** (dymije e tetembedhjete), dite e premte, para meje Noteres Alma I. POSHI, me zyre noteriale ne adresen Rruga "Sulejman Delvina", Nr. 45, Tirane, u paraqitën personalisht palet kontraktuese si vijon, te cilët kerkuan redaktimin e kesaj Kontrate:*

**SHITËSI:**

**Shkëlqim Bozgo,** i biri i Avdi, i datelindjes 06.04.1961, lindur ne Gjirokaster, banues ne Rrugen Tirane, identifikuar ne baze te dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. 025463247, numri personal G10406040I, person madhor, me zotësi të plote juridike per te vepruar,

**Dhenese e Pelqimit – Ina Bozgo**, e bija e Selim, e datelindjes 19.06.1971, lindur ne Tirane, banuese ne Tirane, identifikuar ne baze te dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. 024463822, numri personal H15619093L, person madhor, me zotësi të plote juridike per te vepruar,

**BLERËSI:**

**Abaz Aliko,** i biri i Inos dhe Lales, i datelindjes 08.10.1966, lindur ne Lazarat, Gjirokaster, me gjendje civile i martuar me Zj. Zilo Aliko (numri personal G95128106P), banues ne Njesine Bashkiake nr. 5 Nikolla Tupe, Pall. 6, Tirane, identifikuar ne baze te dokument identifikimi Leternjoftim ID nr. 030117391, me nr. personal G61008024I, person madhore, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, cel. nr. 0694025507,

**BAZA LIGJORE**

Neni 39/c i Ligjit nr. 7829 date 1.6.1994 "Për Noterinë; Neni 73/b i Ligjit Nr. 9901 date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare", Neni 43 i Ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"; Neni 204, 705 e vijues i Kodit Civil.

**MEQENËSE:**

- Shoqëria SEA Consulting SHPK eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe qe ushtron aktivitetin e saj tregtar privat ne perputhje me legjislacionin shqiptar regjistruar ne QKB date **06/03/2018** me NUIS: **L81506016G,**
- Bazuar ne Ekstrakt i Regjistrit Tregtar gjendja e regjistrimit date 04.10.2018 rezulton se: a) Shitësi/ Shkëlqim Bozgo eshte zotërues i 67% të kapitalit themeltar te Shoqerise SEA Consulting SHPK dhe 33% te pjeses tjeter te kapitalit e ka ortaku Entela Shehaj. Kapitali i Shoqerise SEA Consulting SHPK eshte 100.000,00 leke ku numri i pergjithshem i kuotave eshte 2.
- Ky transferim eshte miratuar nga asambleja e ortakeve te shoqerise date 03.10.2018.

**ATËHERE: PALET BIEN DAKORT PER SA ME POSHTE VIJON:**

**NENI 1 – OBJEKTI I KONTRATËS**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, dhe sipas kushteve vijuese, **Shitësi/Shkëlqim Bozgo 33%** te pjesëmarrjes së tij në kapitalin e shoqërisë SEA Consulting SHPK **e transferon** te Blerësi/Abaz Aliko.

**NENI 2 – ÇMIMI I SHITJES**

**2.1.** Kuotat e kapitalit të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate, shiten me vlerën e tyre nominale, për një shumë totale të barabartë me **33.000,00 Leke** (tridhjete e tre mijë), **qe përbën 33% te kapitalit të Shoqërisë.**

**2.2.** Çmimi i shitjes i është shlyer Shitësit totalisht nga Blerësi jashtë kësaj zyre noteriale para nenshkrimit te kesaj kontrate.

**NENI 3 – EFEKTET E TRANSFERIMIT**

Efektet e transferimit të kuotave të kapitalit të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate, nisin nga momenti i nënshkrimit të saj.

Nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate, Blerësi ushtron të gjitha të drejtat që ligji i njeh zotëruesit të kuotave të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate, si nga pikëpamja e ushtrimit të të drejtës së votës dhe të pjesmarrjes në shpërndarjen e fitimit.

**NENI 4 – GARANCITË**

**4.1** Shitësi i jep Blerësit të gjitha garancitë që parashikohen në Kodin Civil të R. Sh. për Shitësin, si dhe e garanton se këto kuota janë të lira nga çdo barrë si dhe për gëzimin e qetë të titullit të pronësisë.

**4.2** Nga une noterja u kerkua informacion prane Regjistrit te Barreve Siguruese dhe nga rezultati i kerkimit nuk rezultoi asnje e dhene e regjistruar, sot date 05.10.2018.

**NENI 5 – TË NDRYSHME**

**5.1.** Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin apo zbatimin e kësaj kontrate, e cila nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim në rrugë bisedimesh do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**5.2.** Kjo kontratë hartohet në 4 kopje në gjuhën shqipe.

**5.3.** Blerësi mori dijeni te regjistrojë këtë kontratë prane Regjistrit Tregtar ne QKB brenda 30 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

*Kontrata pasi u redaktua ju lexua paleve me ze te larte e qarte, te cilet deklaruan se kontrata shpreh vullnetin e lire e te plote te paleve, nenshkruhet prej tyre rregullisht dhe une noterja e vertetoj sipas ligjit.*

**SHITESI** **BLERESI**

Ina Bozgo Abaz Aliko

**N O T E R E**

Alma Poshi

## VENDIM I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

## TE ORTAKEVE TE SHOQERISE "SEA Consulting" SHPK

Sot me date 03.10.2018, ne seline e shoqerise "SEA Consulting" SHPK, shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit ne fuqi, e pajisur me numer unik identifikimi (NUIS) L81506016G, me seli te regjistruar ne Tirane, Rruga e Elbasanit, Nd.36, H.3, Ap.3, u mblodh Asambleja e Ortakeve te Shoqerise per te vendosur ne lidhje me rendin e dites si me poshte vijon:

- Shitjen e 33% (tridhjetetre perqind) te kuotave te zoteruara bashkerisht nga ortaket e shoqerise ne favor te Z. Abaz Aliko, shtetas shqiptar, atesia Ino, lindur ne Gjirokaster me date 8 Tetor 1966 dhe banues ne Tirane ne adresen Rruga "Shyqyri Brari" Ndertesa 3 hyrja 7 Ap 21, Selite, Farke, Tirane, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me Nr. Personal G61008024I .

Jane te pranishem ne Asamblene e Ortakeve:

Z. Shkelqim Bozgo, shtetas shqiptar, atesia Avdi, lindur ne Gjirokaster me date 6 Prill 1961 dhe banues ne Tirane ne adresen: Sheshi "Jozef San Martin", Nd 1 H 9 Ap 19, Tirane mbajtes i leternjoftimit me Nr. Personal G10406040I madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, zoterues i 67% (gjashtedhjeteshtate perqind) te kapitalit te Shoqerise;

Zj. Entela Shehaj, shtetas shqiptar, atesia Ali, lindur ne Gjirokaster me date 12 Gusht 1970 dhe banues Tirane ne adresen: Rruga "Ndreke Luca" Nd.2,H.12, Ap.4, mbajtes i leternjoftimit me Nr. Personal H05812051G madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, zoterues i 33% (tridhjetetre perqind) te kapitalit te Shoqerise.

Meqenese ne kete mbledhje jane te pranishem te gjithe ortaket e shoqerise dhe kuorumi i nevojshem per marrjen e vendimeve te vlefshme eshte plotesuar, Z. Shkelqim Bozgo ne cilesine e Kryetarit te mbledhjes e deklaron ate te mbledhur rregullisht dhe te hapur.

Ne lidhje me rendin e dites, Ortaku Shkelqim Bozgo propozon shitjen e 33% (tridhjetetre perqind te kuotave) te zoteruara nga ai vete ne favor te Z. Abaz Aliko ne shumen 33,000 leke (tridhjetetremije leke).

Pas shqyrtimit te rendit te dites, Ortaket bashkerisht aprovuan shitjen e 33% (tridhjetetre perqind) te kuotave te kapitalit te Shoqerise ne favor te Z. Abaz Aliko.

Per kete qellim, Ortaku Shkelqim Bozgo vendosi te pjestoje kuoten e zoteruar si me poshte vijon:

- Pjesa I e barabarte me 34% (tridhjetekater perqind) te pjesemarrjes ne Kapitalin e Shoqerise;
- Pjesa 2 e barabarte me 33% (tridhjetetre perqind) te pjesemarrjes ne Kapitalin e Shoqerise.

Sa me siper, Ortaku Shkelqim Bozgo propozon te shese ne favor te Z. Abaz Aliko, pjesen 2 te barabarte me 33% (tridhjetetre perqind) te pjesemarrjes ne Kapitalin e Shoqerise, ne shumen 33,000 leke (tridhjetetremije leke).

Sa me siper, Asambleja e Pergjithshrne

**VENDOSI**

1. Pjestimin e kuotave te Ortakut Shkelqim Bozgo ne dy pjese me vlerat si ne vijim:
   - Pjesa I e barabarte me 34% (tridhjetekater perqind) te pjesemarrjes ne Kapitalin e Shoqerise;
   - Pjesa 2 e barabarte me 33% (tridhjetetre perqind) te pjesemarrjes ne Kapitalin e Shoqerise.

2. Shitjen e Pjeses 2 te zoteruar nga Ortaku Shkelqim Bozgo te barabarte me 33 % tridhjetetre perqind) te kuotave te Shoqerise ne favor te Z. Abaz Aliko, ne shumen 33,000 leke (tridhjetetremije leke).

3. Nenshkrimin e Kontrates se shitjes ndermjet Ortakeve te Shoqerise dhe kalimin e 33% (tridhjetetre perqind) te kuotave te Shoqerise ne favor te Z. Abaz Aliko.

Respektivisht, pas nenshkrimit te ketij Vendimi, si dhe pas depozitimit te dokumentacionit prane Qendres Kombetare te Biznesit, kapitali i Shoqerise do te zoterohet nga Ortake dhe ne pjese si me poshte:

1. Z. Shkelqim Bozgo, do te zoteroje 34% (tridhjetekater perqind) te kapitalit te Shoqerise;
2. Zj. Entela Shehaj, do te zoteroje 33% (tridhjetetre perqind) te kapitalit te Shoqerise;
3. Z. Abaz Aliko, do te zoteroje 33% (tridhjetetre perqind) te kapitalit te Shoqerise;

Pasi nuk pati me ceshtje per te diskutuar, Kryetari i mbledhjes e deklaron ate te mbyllur.

Ortaket e Shoqerise tregtare "SEA Consulting" SHPK

Shkelqim Bozgo Entela Shehaj

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT**

# EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L81506016G | |
| 2. Data e Regjistrimit | 06/03/2018 | |
| 3. Emri i Subjektit | SEA Consulting | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 05/03/2018 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 05/03/2018 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Rruga e Elbasanit, Nd.36, H.3, Ap.3 | |
| 8. Kapitali | 100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 2,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Ofrimi i sherbimeve te konsulences per analiza dhe zhvillim biznesi me perparesi ne sektorin e energjise, perfshi aspektet rregullatore, manaxheriale, plane biznesi, si dhe ne fushat ekonomike, te administrimit te biznesit, te Tatim Taksave, e ne fusha te ngjashme apo te lidhura me to si dhe cdo veprimtari tjeter e lejuar nga ligji. | |
| 10. Administratori/ët | Shkëlqim Bozgo | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 05/03/2018 | Deri: 05/03/2023 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Ortakët | ShkëlqimBozgo | |
| 12.1 Vlera e kapitalit | Para: 67.000,00 | Natyre: |
| 12.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 67,00 | |

Kopje nga web

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

| | | |
|---|---|---|
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 13. Ortakët | EntelaShehaj | |
| 13.1 Vlera e kapitalit | Para: 33.000,00 | Natyre: |
| 13.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 33,00 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | | |
| 15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: SEA Consulting<br>Telefon: 0694027999 | |
| 16. Statusi: | Aktiv | |

Lista e Dokumenteve:
Mandati bankar ose vertetimi i noterit per pagesen e kapitalit ne para - (nese kapitali eshte paguar)
Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)

Regjistrimi Fillestar: CN-692081-03-18

## HISTORIKU I REGJISTRIMIT

| Data e regjistrimit | Ndryshimi i te dhenave te regjistruara |
|---|---|

Datë: 04/10/2018

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga Web

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20181005131247876 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 05.10.2018 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 1:12:47PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-043-547 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

SHKELQIM AVDI BOZGO
SEA CONSULTING SH.P.K.

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA